



Kompania Rajonale e Ujesjellesit
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

Hidromorava Gjilan
KOMPANIA RAJONALE
E UJESJELLESIT
HIDROMORAVA Sh.a.
No. 183 Data 27.02.2026
GJILAN

Në bazë të dispozitave të nenit 21. lidhur me nenin 25. Paragrafi 25.2. pika (h) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, respektivisht nenit 13. të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava"-Sh.A. Gjilan, në mbledhjen e tretë të mbajtur me datë 27.02.2026 mori vendim që të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës punuese :

- Titulli i pozitës: Zyrtar i Auditimit të Brendshëm
- Nr. i ekzekutuesve: një /1/
- Paga: 1152 euro
- Orari i plotë: 40 orë në javë
- Vendi i Punës: Gjilan

Detyrat dhe Përgjegjësitë :

- Ushtron funksionin në mënyrë objektive, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021 dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm për sektorin publik, të miratuar nga Ministria e Financave;
- Vepron në përputhje me Standardet e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit dhe Kodin e Etikës; Përgatitë Planet Strategjike dhe Planet Vjetore konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe proceseve që zhvillohen në kuadër të ndërmarrjes dhe dorëzimi i tyre sipas afateve të përcaktuara me ligj;
- Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm;
- Përgatitja e letrave të punës me përmbajtje të mjaftueshme, kompetente dhe relevante për të mbështetur gjetjet në raportet e auditimit, harton raporte preliminare të auditimit dhe rekomandimet;
- Monitoron dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të Aksionarit, Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit në përputhje me Planin e Biznesit të ndërmarrjes;
- Kërkon nga cilido zyrtar, punonjës ose kontraktues i shërbimit nën auditim që të ofroj dëshmi fizike, shënime dhe dëshmi gojore ose informata të tjera mbi çështjet që kanë të bëjnë me auditim ose mbi aktivitetet që janë nën auditim;
- Zhvillon programet e auditimit dhe pyetësorëve adekuat për verifikimin e funksionimit të kontrollave të brendshme për angazhim të ri, rishikim dhe përmirësim të programeve dhe pyetësorëve ekzistues;
- Kryen auditime individuale për të siguruar përshtatshmërinë e objektivave dhe fushëveprimit të auditimit, përshtatshmërinë e testimit të kryer dhe saktësinë e konkluzioneve të arritura;
- Përgatit raporte të auditimit duke identifikuar përparësitë dhe dobësitë, përfshirë dhënien e rekomandimeve dhe konkluzioneve;
- Prezenton tek Komisioni i Auditimit raportet e auditimit për aprovim;



Kompania Rajonale e Ujesjellesit
"Hidromorava" S.H.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

- Përcakton objektivat, fushëveprimin , shpeshhtësinë, metodat dhe burimet e nevojshme për kryerjen e Auditimit të Brendshëm;
- Është i obliguar të mbajë në fshehtësi të gjitha informacionet që atij i janë bërë të njohura gjatë kryerjes së auditimit të brendshëm, përveç nëse kërkon ndryshe;
- Dërgon raportet gjashtë mujore dhe vjetore te Ministria e Financave – Njësia Qendrore Harmonizuese më së largu deri më pesëmbëdhjetë korrik të vitit, respektivisht deri me pesëmbëdhjetë janar të vitit pasues;
- Raporton rregullisht tek Komisioni i Auditimit;
- Përveç detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara, kryen edhe auditime tjera shtesë me kërkesë të Komisionit të Auditimit dhe Kryeshefit Ekzekutiv, konform legjislacionit në fuqi;
- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Për punët e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Komisionit të Auditimit, kurse për çështje administrative i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Kualifikimet dhe aftësitë :

- Në harmoni me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet (Ligji për kontrollin e brendshëm të financave publike nr.06/L-021, neni 22. Paragrafi 2.1.);
- Përvoja e punës në harmoni me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087;
- Të jetë kontabilist i çertifikuar (sipas Ligjit Nr.04/L-111, neni 13. për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit bazik Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike);
- Të ketë çertifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave (Ligji për kontrollin e brendshëm të financave Publike Nr. 06/L-021, neni 22. Paragrafi 2.2.
- Të ketë aftësi organizative dhe shkathtësi komunikimi në të shkruar dhe në të folur;
- Njohja e punës me kompjuter word/exel dhe programe softwerike për financa dhe kontabilitet.

Informatë e përgjithshme për Kandidatët lidhur me procedurat e konkurimit
Kandidatët për pozitën e lartëcekur duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Diplomë e universitetit;
- Certifikatat për Kontabilist i çertifikuar dhe Auditor i Brendshëm i çertifikuar;
- CV-në;
- Letër motivimi (jo më shumë se 500 fjalë);
- Dëshmitë për kualifikime tjera profesionale;
- Dëshmitë e përvojës së punës (dëshmitë e kualifikimit profesional , përvojës së punës - të noterizuara) të dëshmuara përmes Trustit;
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1. dhe 17.2. të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Çertifikatën (dëshminë) se nuk është nën hetime;
- Kopjen e pasaportës ose të letërnjoftimit (shtetas të Republikës së Kosovës).



**Kompania Rajonale e Ujesjellesit
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan**

Afati i aplikimit është 21 ditë nga dita e shpalljes publike të konkursit në webfaqen e KRU "Hidromorava"-SH.A. në gazetën ditore, në tabelën e shpalljeve publike të Kompanisë.
Afati i aplikimit është nga data 03.03.2026 deri më datë 23.03.2026.

- Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në email adresen: rekrutimi.hidromorava@gmail.com.

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të njoftohen për vendin, dhe kohën e mbajtjes së intervistës me gojë përmes postës elektronike dhe tabelës së shpalljeve publike të Kompanisë.

**Komisioni i Auditimit
KRU Hidromorava Sh.A.**

